



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË DIVJAKË

Divjakë, më: 28 / 12 / 2021

Nr. 5124/34

V E N D I M

Nr. 66, datë 28 / 12 / 2021

P Ë R

MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE TË BASHKISË, INSTITUCIONEVE NË VARTËSI, TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE FUNKSIONET E DELEGUARA PËR VITIN 2022

Në mbështetje të nenit 54, pika (dh), të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë Divjakë në mbledhjen e datës 28.12.2021, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin e paraqitur nga Bashkia Divjakë,

Vendosi:

1. Miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Divjakë, institucioneve në vartësi, Njësive Administrative dhe funksioneve të deleguara si vijon;

1.1 . Në administratën e Bashkisë Divjakë	134 punonjës
1.2 . Në Agjencinë e Shërbimeve Komunale	106 punonjës
1.3 . Në Njësinë Administrative Tërbuf	32 punonjës
1.4 . Në Njësinë Administrative Gradishtë	27 punonjës
1.5 . Në Njësinë Administrative Grabian	18 punonjës
1.6 . Në Njësinë Administrative Remas	22 punonjës
1.7 Sektori i Arsimit	71 punonjës
1.8 Sektori i Pyjeve	1 punonjës
1.9 Sektori i Ujitjes dhe Kullimit	25 punonjës
1.10 Drejtoria e Rrugëve Rurale	12 punonjës
1.11 Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	14 punonjës

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Burimeve Njerëzore, IT dhe Protokoll/Arkiva, Agjencia e Shërbimeve Komunale dhe Njësiti Administrative pranë Bashkisë Divjakë.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetare Këshillit Bashkiak
ANA NAKO





REPUBLIKA E SHQIPERISE

KESHILLI BASHKIAK DIVJAKE

5124/37
Nr.....Prot

Divjake me 28/7 2021

VENDIM

Nr. 69 Date 28/7 2021

**“MBI MIRATIMIN E BUXHETIT ,NUMRIT MAKSIMAL TE PUNONJESVE TE BASHKISE DHE
NDERMARRJET VARTESE TE BASHKISE PER VITIN 2022 DHE PROGRAMIN BUXHETOR
AFATMESEM 2022-2024”**

Mbeshtetur ne ligji Nr. 139/2015, date 07/12/2015 “Perveteqeverisjenvendore” neni 54 pika ç dhe dh, te ligjit nr.68/2017 dt.27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore” neni 40 dhe 41 si dhe ligjin 9936 dt 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise” neni 6,32 i ndryshuar , Udhezimit nr 9 dt.20.03.2018”Per procedurat standarte te zbatimiti te buxhetit “ si dhe materialeve te paraqitura nga administrata e bashkise ne mbledhjen e Keshillit bashkiak,

VENDOSI

I-Te miratoje Programin Buxhetor Afatmesem 2022-2024 sipas pasqyrave bashkangjitur .

II-Te miratoje planin e te ardhurave per vitin 2022 si me poshte vijon :

<i>a-Te ardhura gjithsej</i>	625.111.849leke
<i>-Te ardhura te trasheguara nga viti 2021</i>	38. 217.849leke
<i>-Te ardhura nga taksat dhe tarifat vendore</i>	253.580.000leke
<i>-Te ardhura nga transferta e pakushtezuar (granti 2022)</i>	220.870.000leke
<i>-Te ardhura nga transferta e pakushtezuar sektoriale 2022</i>	112.444.000leke
<i>-Fondi i kushtezuar per emergjencat civile</i>	0leke
<i>b-Plani i shpenzimeve te Bashkise Divjake per vitin 2022 eshte</i>	625.111.849leke
<i>i detajuar si me poshte :</i>	
<i>-Shpenzime korente</i>	491.102.000leke
<i>-Shpenzime kapitale (231)</i>	134.008.849leke



Nga cilat

a-Parat (600)

253.219.000leke

42.202.000leke

b-Sigurimet shoqerore (601)

181.381.000leke

c-Shpenzime operative dhe mirembajtje (602)

Pjese e shpenzimeve operative eshte

4.700.000leke

-Shperblim per Keshilltaret

3.900.000leke

-Shperblim per Kryetaret e fshatrave

14.300.000leke

d-Per transferta (604-606)

6.300.000leke

-Per emergjencat civile

7.500.000leke

-Per fondin rezerve dhe fondin e kontegjences

500.000leke

-Kontribut per Keshillin e Qarkut

III-Te miratoje detajimin e buxhetit tete ardhurave dhe shpenzimeve te Bashkise Divjake sipas pasqyrave nr 1 ,1/1/2 ,pasqyra nr 2 dhe 2/1,pasqyra nr2/2 dhe 2/3 pasqyra nr .3 ,pasqyra nr,4 ,pasqyra nr,5”Investime” ,pasqyra nr.6” Transfertata sektoriale “ ,pasqyra nr,7”shpenzime operative”,pjese perberese te ketij vendimi.

IV-Te miratoje rritjen e limitit te te ardhurave te Bashkise Divjake per vitin 2022 per diferencen e papedorur te te ardhurave dhe shpenzimeve per vitin 2021 pas rakordimit perkates perfundimtar .

V-Per shpenzimet nga te ardhurat e trasheguara te behet korektimi perkates pas perfundimit te rakordimit perfundimtar te te ardhurave dhe shpenzimeve ne Degen e Thesarit per vitin 2021.

VI-Ngarkohet Nepunesi Autorizues dhe Drejtoria e Finances per detajimin e shpenzimeve ne periudha mujore ,menjehere pasi te vihet ne dispozicion limiti i percaktuar sipas periudhave perkatese nga Minsitria e Financave dhe Ekonomise.

VII-Ngarkohet nepunes autorizues i bashkise te kryeje rishperndarje gjate zbatimit te buxhetit 2022 si me poshte:

-Ndermjet projekteve te investimeve brenda te njetit program.

-Ndermjet zerave te shpenzimeve korrente ,brenda te njetit program .

-Rishperndarja brenda te njetit program dhe zerit te shpenzimeve korente ndermjet Njesive te ndryshme shpenzuese ,te cilat miratohen nga Nepunesi Autorizues i NJ.Q.V nga e cila varet njesia shpenzuese.

VIII-Ngarkohet Drejtoriae Buxhetit dhe Finances per avancim te fondeve mujore sipas realizimit te te ardhurave per vitin 2022.

IX-Te miratoje numrin maksimal te punonjesve te bashkise si dhe te njesive administrative e institucioneve buxhetore ne varesi et Bashkise Divjake 462 punonjes,nga te cilet

-Njesia shpenzuese bashkia Divjake 351 punonjes te perhershem.

-Njesia shpenzuese "Agjensia e sherbimeve Komunale " 106 punonjes .

-Gjendja civile 5punonjes te perhershem .

XI-Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

Kryetari I Keshillit Bashkiak

Ana NAKO





REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI QARKU FIER

Nr. 13/1 Prot.

Nr. 5124/41
Dt. 14.01.22.

Fier, më 12.01.2022

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimit Nr. 65, dhe Nr. 69, të Këshillit të Bashkisë Divjakë, të miratuara në mbledhjen e datës 28.12.2021.

BASHKISË DIVJAKË

KËSHILLIT TË BASHKISË DIVJAKË

Divjakë

Në përgjigje të shkresës Tuaj me Nr. 5124/39 prot. datë 31.12.2021 protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr.13 prot. datë 07.01.2021, bazuar në ligjin Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 8 shkronja "a", neni 16 si dhe në ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3 pika 2, pasi verifikuam ligjshmërinë e vendimit me karakter normativ të Këshillit të Bashkisë Divjakë, të miratuara në mbledhjen e datës 28.12.2021, shoqëruar me procesverbalin Nr. 16, datë 24.12.2021, të mbajtur në Librin e Procesverbalit të mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Divjakë me Nr. 2717 prot. datë 09.09.2021, procesverbalet e këshillimit publik si dhe dokumentacionin plotësues të vendimit, shprehemi si më poshtë:

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Divjakë Nr. 65, datë 28.12.2021 "Paketa fiskale për sistemin e taksave e tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022", shoqëruar nga projektvendimi i protokolluar me Nr. 5124/20 prot. datë 20.12.2021, relacioni Nr. 5124/21 prot. datë 20.12.2021, procesverbalet e dëgjësave publike, **Është në përputhje** me ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 8 pika 2, neni 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe neni 54 shkronja "f", ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar), ligjin Nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" kreu III, ligjin Nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare" (i ndryshuar), ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), ligjin Nr. 10081, datë 23.02.2009 "Për licencat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), ligjin Nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i ndryshuar), ligjin Nr.

8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” (i ndryshuar), VKM Nr. 607, datë 29.7.2020, “Për tarifatat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” (i ndryshuar), ligjin Nr. 8098, datë 23.03.1996 “Për statusin e të verbërit” (i ndryshuar), ligjin Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar), ligjin Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit” (i ndryshuar); VKM Nr. 132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” (i ndryshuar).

Vendimi i Këshilit të Bashkisë Divjakë Nr. 69, datë 28.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të bashkisë dhe ndërmarjet vartëse të bashkisë për vitin 2022 dhe programin buxhetor afatmesëm 2022-2024” shoqëruar nga projektvendimi i protokolluar me Nr. 5124/22 prot. datë 20.12.2021, relacionin Nr. 5124/23 prot. datë 20.12.2022, procesverbalet e dëgjësave publike, **Është në përputhje me ligjin nr. 139/2015** “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 8, pika 2, neni 9, pika 1 nënpika 1.1 shkronja “b”, neni 41, pika 1, neni 54 gërma “dh”, ligjin Nr. 9936, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 15, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 6, shkronja “ç” dhe “d”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” si dhe në zbatim Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të programit afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI
Lefter SHEHAJ

